



REPUBLIKA E SHqipërisë  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

## AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

### PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË ARSIMIT FILLOR 2021

#### 1. HYRJE

Profesioni i mësuesit kërkon përkushtim, përgjegjshmëri dhe standarde të larta pune dhe etike. Mësuesi vepron me ndershmëri dhe integritet të lartë profesional, zotëron përmbytjen e lëndëve që jep mësim, përditëson dijet dhe aftësitë e tij nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikimeve që zhvillon, krijon dhe pasuron vazhdimisht portofolin e tij profesional, përfshihet në procesin e vetëvlerësimit, dokumenton vlerësimet që i bëhen, krijon marrëdhënie korrekte me prindërit në interesin më të mirë të fëmijëve.

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të arsimit fillor, është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t'u ardhur në ndihmë mësuesve në kuadër të përgatitjes së tyre për testimin kombëtar, si dhe të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar, për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit, që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MASR-ja ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve, të cilat janë:

- dokumentacioni zyrtar<sup>1</sup> shkollor, i cili ka të bëjë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve në shkollë;

<sup>1</sup> Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASR-së që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- programet lëndore nga klasa 1-5;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimor në arsimin fillor;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndëve në arsimin fillor, nga klasa 1-5.

## 2. QËLLIMI I PROGRAMIT

Qëllimi i hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi është:

- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të arsimit fillor, për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DRAP-eve, ZVAP-eve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt, programi mund të plotësohet nga DRAP-et, ZVAP-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- të ofrojë një program të detyruar për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.

### **Nëpërmjet programit të kualifikimit, mësuesi përgatitet për testim. Ai:**

- njeh dhe zbaton legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- zotëron kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- demonstroi aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- tregon përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndëve, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- njeh konceptin e gjithëpërfshirjes dhe demonstroi përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në veprimtaritë e shkollës;
- demonstroi zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit përgjatë punës së tyre në shkollë;
- zotëron zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe;

- përdor aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca.

### 3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të përcaktuar. Për secilën fushë, përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndëve.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

<b>FUSHA: DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR</b>	
<b>Kompetenca</b> “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor”	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i arsimit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe dispozitat normative të këtij sistemi;</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës;</li> <li>• demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MASR-së në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënies.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar</li> <li>• Udhëzuesi “Për fillimin e vitit shkollor 2020-2021”, ASCAP (gusht 2020)</li> <li>• Shtojca 1 “Për disa plotësime në Udhëzuesin e fillimit të vitit shkollor 2020 – 2021”</li> <li>• Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020</li> <li>• Urdhri Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”</li> </ul>

<p>nxënies;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton etikën profesionale të mësuesit;</li> <li>• respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit;</li> <li>• respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</li> <li>• zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”</li> <li>• Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”</li> <li>• Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”</li> <li>• Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”</li> </ul>
--	---

FUSHA: PROGRAME LËNDORE	
Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve lëndore”	Literatura e rekomanduar
<p><i>Mësuesi i arsimit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>qëndron</i> i mirinformuar për të rejtat e reformës kurrikulare, pjesë e të cilës është edhe arsimi fillor;</li> <li>• <i>zbaton</i> programet lëndore duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tyre;</li> <li>• <i>përdor</i> me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetit të zbatimit të programeve lëndore dhe të integritimit ndërlëndor;</li> <li>• <i>përdor</i> materiale plotësuese kurrikulare</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar, 2014</li> <li>• Kurrikula bërthamë klasat KP-5, 2014</li> <li>• Programet lëndore për klasat 1-5</li> </ul>

<p>që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>harton</i> objektiva (rezultate të nxëni) për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me objektivat (shkathtësitë) e programit;</li> <li>• <i>shpjegon</i> lidhjen program-tekst-plan mësimor vjetor dhe periudhash;</li> <li>• <i>planifikon</i> projekte kurrikulare dhe module mësimore;</li> <li>• <i>përzgjedh</i> mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programeve lëndore;</li> <li>• <i>harton</i> teste sipas kritereve të caktuara për të vlerësuar njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet e nxënësve në lëndë të ndryshme të ciklit fillor;</li> </ul>	
--	--

<b>FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE</b>	
<b>Kompetenca I</b> <b>“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien në arsimin fillor”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><i>Mësuesi i arsimit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>është</i> njohës i mirë i aspekteve didaktike dhe pedagogjike të mësimdhënies, i stileve të të nxënit dhe i psikologjisë moshore të nxënësve me të cilët punon;</li> <li>• <i>shfrytëzon</i> literaturën bashkëkohore për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza kurrikulare, 2014</li> <li>• Kurrikula bërthamë AMU, klasat I-V, 2014</li> <li>• Udhëzues për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë dhe për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020, ASCAP, (maj 2020)</li> <li>• Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit e tij.</li> </ul>

<p>të nxënit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>analizon</i> elementet që i bashkojnë dhe i dallojnë llojet e mësimdhënies me njëra-tjetrën;</li> <li>• <i>menaxhon</i> situata, sjellje dhe veprime të ndryshme nxënësish;</li> <li>• <i>zotëron</i> aftësitë dhe kompetencat profesionale që i duhen mësuesit të ciklit fillor;</li> <li>• <i>zhvillon</i> mësimdhënie të diferencuar;</li> <li>• <i>dallon</i> vështirësinë në të nxënë nga aftësia e kufizuar;</li> <li>• <i>harton</i> plane edukative individuale (PEI);</li> <li>• <i>krijon</i> klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;</li> <li>• <i>planifikon</i> orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin;</li> <li>• <i>prezanton</i> materiale didaktike duke përdorur programet më të njohura kompjuterike.</li> </ul>	
<p style="text-align: center;"><b>Kompetenca II</b></p> <p><b>Përdorimi i metodave ndërvepruese dhe i formave të ndryshme të punës me nxënësit e kësaj moshe, realizimi i integritit ndërlëndor</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Literaturë e rekomanduar</b></p>
<p><i>Mësuesi i ciklit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>motivon</i> nxënësit në forma e mënyra efektive;</li> <li>• <i>zbaton</i> metodat ndërvepruese të mësimdhënies në përshtatje me lëndën, temën e mësimin dhe me moshën e nxënësve;</li> <li>• <i>planifikon</i> veprimtari që nxisin të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të nxënit me situata, kompetenca dhe situata e të nxënit, IZHA 2014</li> <li>• Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015</li> <li>• Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës së re në Arsimin Fillor, IZHA, 2018</li> <li>• Nivelet e arritjes së kompetencave të fushave të të nxënit, (arsimi fillor) klasa I-III dhe IV-</li> </ul>

<p>menduarit kritik e krijues të nxënësve;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>krijon</i> klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;</li> <li>• <i>planifikon</i> orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin;</li> <li>• <i>përdor</i> metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve;</li> <li>• <i>përdor</i> metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen.</li> </ul>	<p>V, IZHA, mars 2019</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese, planifikimin e punës me fëmijët me aftësi të kufizuar, hartimin e planit edukativ individual, disiplinimin pozitiv të sjelljes së nxënësve në klasë etj.</li> </ul>
<p style="text-align: center;"><b>Kompetenca III</b></p> <p><b>Përdorimi i instrumenteve të ndryshme të vëzhgimit dhe të vlerësimit të nxënësve</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Literaturë e rekomanduar</b></p>
<p><i>Mësuesi i ciklit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>përdor</i> mënyra e strategji të ndryshme të dokumentimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të nxënësve;</li> <li>• <i>vëzhgon</i> dhe vlerëson me përshkrim ecurinë dhe përparimin e nxënësit, duke përdorur instrumente të ndryshme;</li> <li>• <i>dokumenton</i> detyra e punime të nxënësve që dëshmojnë përparimin dhe interesin e tyre për shkollën dhe komunitetin përreth;</li> <li>• <i>punon</i> me prindërit për përmirësimin e përparimit të nxënësit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”</li> <li>• Udhëzim nr. 4, datë 11.04.2016, “Për zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor”</li> <li>• Korniza e vlerësimit të nxënësit në arsimin parauniversitar, IZHA 2015</li> <li>• Nivelet e arritjes së kompetencave të fushave të të nxënit, (arsimi fillor) klasa I-III dhe IV-V, IZHA, mars 2019.</li> <li>• Udhëzues për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë dhe për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020, ASCAP, (maj 2020).</li> <li>• Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), ASCAP, 2019</li> </ul>

**FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT**

<b>Kompetenca</b> <b>“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”</b>	<b>Literatura</b>
<p><i>Mësuesi i ciklit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• <i>njeh</i> rregullat e etikës dhe të sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;</li><li>• <i>sillet</i> në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Kodi i etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar publik dhe privat, miratuar nga ministri i Arsimit dhe Sportit, më 30.11.2013</li><li>• Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”</li></ul>

**FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE**

<b>Kompetenca</b> <b>“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”</b>	<b>Literatura</b>
<p><i>Mësuesi i arsimit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• <i>zbaton</i> rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe, në të folur, në të lexuar dhe në të shkruar;</li><li>• <i>zbaton</i> rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe në çdo veprimtari në institucionin arsimor.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Drejtshkrimi i gjuhës shqipe</li></ul>



**FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËVE TË ARSIMIT FILLOR**

<b>Kompetenca</b> <b>Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësime të lëndëve të ciklit fillor</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><i>Mësuesi i arsimit fillor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• <i>zotëron</i> konceptet shkencore, dukuritë, ligjësitë në nivel shkencor dhe didaktik;</li><li>• <i>transmeton</i> konceptet shkencore, dukuritë, ligjësitë dhe rregullat në përshtatje me moshën dhe të nxënësve;</li><li>• <i>zotëron</i> njohuritë, aftësitë dhe shprehjet që fitojnë nxënësit nga klasa 1-5 për çdo program lëndor;</li><li>• <i>planifikon</i> sipas vështirësive tipike që hasin nxënësit gjatë procesit mësimor;</li><li>• <i>përshtat</i> programet lëndore për nxënësit që paraqesin vështirësi në të nxënë ose që janë me aftësi të kufizuara.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Të gjitha programet lëndore që përmban plani mësimor, klasat 1-5.</li><li>• Tekstet shkollore nga klasa 1-5</li><li>• Botime të ndryshme në ndihmë të mësuesve dhe nxënësve</li></ul>